



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

68/17
Nr/Bр. 13.04.2017
Date/Datum
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 68/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankesa “Linda Sh.p.k” - Gerlicë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pran Lumit Nerodime - projekt 3 vjeçar”, me nr prok: “656/16/245/521”, i iniciuar nga autoriteti kontraktues / Komuna e Ferizajit /, më datën 07.04. 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “Linda Sh.p.k” - Gerlicë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pran Lumit Nerodime - projekt 3 vjeçar”, me nr prok: “656/16/245/521”, i iniciuar nga autoriteti kontraktues / Komuna e Ferizajit /.
- II. Anulohet, vendimi për dhënie të kontratës i AK-së / Komuna e Ferizajit /, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pran Lumit Nerodime - projekt 3 vjeçar”, me nr prok: “656/16/245/521”dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

- IV. Operatorit ekonomik ankues OE “Linda Sh.p.k” - Gerlicë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa i është aprovuar si pjesërisht e bazuar.
- V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datën: 05.10.2016.

Hapja e ofertave është bërë me datën: 25.10.2016, ku kanë marr pjesë tetë (8) operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm “Linda Sh.p.k” – Gerlicë” është bërë me datën: 22.02.2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me datën: 22.02.2017, e ku është rekomanduar për kontratë konsorciumi “Ntp Mali Art & Avduli Sh.p.k” - Kaçanik.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik “Linda Sh.p.k” - Gerlicë, me datën: 27. 02. 2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me datën: 28.02.2017, autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Linda Sh.p.k” – Gerlicë.

Operatori ekonomik “Linda Sh.p.k” - Gerlicë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 07 Mars 2017 me nr. 68/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pran Lumit Nerodime - projekt 3 vjeçar”, me nr prok: “656/16/245/521”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së – (Qëllimi i Ligjit)
- Neni 7 i LPP-së – (Barazia në trajtim/ Jo diskriminim)
- Neni 57 i LPP-së – (Sigurimi i Tenderit)

- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe kahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së – (Kriteret e dhënies së kontratës)
- Neni 61 i LPP-së – (Tenderi jo normalisht i ulët)
- Neni 65 i LPP-së – (Përshtatshmëria Profesionale)
- Neni 71 i LPP-së – (Grupet e Operatorëve ekonomik dhe Operatorëve të hua)j

Organë Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 23 mars 2017, i ka propozuar panelit shqyrtues që të Aaprovoj vendimin e AK- Komuna e Ferizajit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i shtratit të Lumit te Bifurkacioni dhe trotuaret pran Lumit Nerodime - projekt 3 vjeçar”, me nr prok: “656/16/245/521”, ndërsa ankesën e OE “Linda Sh.p.k” – Gerlicë, ta hedhë poshtë si të pa lejuar.

Operatori ekonomik ankues “Linda Sh.p.k” – Gerlicë, me datën: 24 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.04.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i iniciimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik ankues “Linda sh.p.k” – Gerlicë, ka deklaruar: “Ne si OE nuk pajtohemi në asnjë mënyrë me ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe mendojmë se ka shkelje të rënda në gjitha pikat ankimore që kemi bërë. Ne e dimë që vlerësimi bëhet sipas kritereve të AK-së që kërkon dhe aty kemi një rast ku thotë “certifikata e biznesit dhe kodet adekuate”. OE fitues këto nuk i ka. Eksperti shqyrtues e arsyeton padrejtësisht këtë. Kërkesa për referanca, OE fitues nuk e plotëson as këtë kërkesë, dhe eksperti prapë e arsyeton. OE fitues është në konsorcium, me kompaninë Avdyli. Pas qasjes në dokumente zyrtare kemi konstatuar dhe e kemi me vete dokumentin, ku marrëveshja konsorciumit nuk është adekuate dhe nuk përfshinë gjitha pikat që duhet. Po ashtu oferta financiare është e pavulosur prej kompanisë Avduli dhe e panënskruar. Kjo patjetër duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga dy OE-të në konsorcium. Po ashtu edhe polica e

sigurimit është vetëm në emër të OE Mali i Artë. Që edhe kjo duhet të jetë sipas marrëveshjes së konsorciumit. Eksperti nuk di a nuk i ka vërejt këto apo nuk ka dashtë mi pa. Edhe marrëveshja e konsorciumit nuk është në rregull dhe është normale që në të gjitha pikat nuk pajtohem. Nuk më befason fakti i EO fitues që nuk i ka kodet, se ai as idenë nuk e ka çka është kjo punë pasi i njëjti merret me Gastronomi-Hoteleri. Me qenë se eksperti shqyrtues thotë se ky kod nuk është i nevojshëm do pyesja ekspertin pse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka caktuar këtë kod, pse ekziston ky kod dhe pse unë e kam e OE fitues nuk e ka. Sa i përket referencave, OE ka referenca të rrugëve, eksperti arsyeton dhe thotë që janë të ngjashme. Në projektin që do punohet është shumë specifik për ndërtim të shtratit të lumit dhe nonstop duhet të punohet nën presionin e ujit, dhe për këtë nuk janë të ngjashme. Ne i propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë dhe lënda të kthehet në Rivlerësim”.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së ka deklaruar: “Pretendimi ankimor për marrëveshjen e konzorciumit, i njëjti pretendim është trajtuar përmes raportit të ekspertizës paraprake, ku edhe vendimi i panelit shqyrtues nr.421-437/16, e ka vërtetuar që e njëjta marrëveshje është adekuate sipas kërkesës së AK-së. Ndërsa pretendimet tjera si sigurimi i tenderit, kam sqaruar përmes raportit se sigurimi i ofruar prej OE të rekomanduar për kontratë, pas rivlerësimit të ofertave përban të dhënat siç ka kërkuar AK-ja, si periudhën kohore, vlerën, titullin e aktivitetit dhe numrin e prokurimit. Për kundër asaj që i njëjti sigurim është lëshuar në emër të anëtarit OE ”Mali i Artë”, i njëjti sipas marrëveshjes dhe autorizimit pjesë e ofertës së tij është caktuar si lider i grupit. Po ashtu edhe pretendimi tjetër lidhur me ofertën financiare ku potencon se është nënshkruar vetëm prej njërit nga anëtarët e konsorciumit, përmes raportit kemi sqaruar çmimi total i ofertës pjesa C formulari i tenderit është i nënshkruar dhe vulosur nga dy anëtarët e grupit. Po ashtu edhe certifikata e biznesit siç potencon OE ankues e kemi sqaruar në raportin paraprak të ekspertizës po edhe në këtë raport që, natyra e aktivitetit të prokurimit duke ju referuar paramasës është adekuate e jo vetëm njërit nga anëtarët e konsorciumit po që të dy anëtarët certifikatën e kanë adekuate për këtë projekt. Ndërsa arsyeva pse kam rekomanduar që ankesa e OE ankues të hedhet e palejuar është se për këtë aktivitet të prokurimit i njëjti ankues për nga çmimi i ofruar renditet i katërti për nga çmimi, ndërsa përmes deklaratës në ankesë konteston – ankimoni vetëm OE të rekomanduar për kontratë pas rivlerësimit të ofertave. Një gjë e tillë është e paraparë me nenin 111 par.1 nënpar.1.16 dhe 1.8 të LPP në fuqi”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ”Komuna e Ferizajit” ka deklaruar: ”Në përgjithësi përkrahim mendimin e ekspertit shqyrtues njëherit edhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues andaj tërësisht e përkrahim mendimin dhe analizat e ekspertit. Duhet të shtoj se për këtë lëndë ne kemi qenë në të njëjtin panel në shqyrtim dhe fitues atëherë ka qenë fitues OE ”Linda”, dhe ankesa ka qenë e OE ”Mali Artë” dhe nga i njëjti panel është aprovuar ankesa e ”Mali i Artë” se vendimi i AK ka qenë jo

valid, andaj me vendimin e OSHP-së lënda është kthyer në Rivlerësim dhe komisioni i ri ka bërë vlerësimin e të gjitha ofertave dhe në fund ka vendos që fitues të jetë Mali i Artë”.

Kryetari i panelit shqyrtues pasi konstatoi se në nenin 11.1 të dosjes së tenderit është kërkuar deklaratë e qartë ku gjithë anëtarët janë përgjegjës bashkërisht dhe veç e veç, deklaratë e nënshkruar nga anëtarët duke konfirmuar se marrin pjesë në grup dhe jo në mënyrë individuale apo grup tjetër në të njëjtën procedurë, dhe se deklarata e nënshkruar nga gjithë anëtarët që autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, pyeti ekspertin shqyrtues dhe përfaqësuesin e AK-së se a duhet të gjithë anëtarët e grupit të jenë të përshtatshëm dhe a duhet të sigurojnë dëshmi se janë të përshtatshëm si në par. 4 të DT ?

Në përgjigje, eksperti shqyrtues deklaroj: “Edhe në raportin paraprak, pikërisht kjo ka qenë arsy e eliminimit të OE tanë të rekomanduar. Pikërisht marrëveshja konsorciumit e kam trajtuar në ekspertizën paraprake ku i njëjtë pretendim është konstatuar edhe përmes vendimit të panelit me nr.421-437/16 i datës 20.12.2016. Megjithatë prap sqaroj se OE i rekomanduar për kontratë pas rivlerësimit të ofertave, në shkresa të ofertës poseton marrëveshjen mbi themelimin e grupit të konsorciumit, e njëjta është nënshkruar dhe vulosur nga dy anëtarët, dhe po ashtu përban datën 25.10.2016 ku janë të definuara detyrat dhe përgjegjësitë e grupit. Po ashtu në shkresa posedojnë edhe autorizimin e datës 25.10.2016 të vulosur dhe nënshkruar nga dy anëtarët, si dhe sqarimi për detyrat dhe përgjegjësitë për këtë aktivitet të prokurimit do thotë janë të precizuara. Në marrëveshje deklarojnë se janë bashkëpjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit ku i kanë të precizuara edhe përgjegjësitë. Nuk jam në dijeni se kanë a deklarata veç e veç mirëpo mendoj se deklarata që ceka më lart plotëson kërkesat e AK-së”.

Kryetari i panelit pyeti ekspertin shqyrtues, OE-të kanë nënshkruar dhe vulosur që të dy, kanë caktuar personin përgjegjës mirëpo nuk kanë vendos vulën e konzorciumit, a është plotësuar si duhet ky formular nga OE i rekomanduar ?

Në përgjigje eksperti shqyrtues ka deklaruar: “Çmimet e paramasës janë të nënshkruara dhe vulosura nga lideri i grupit të konzorciumit, ndërsa pjesa C e dosjes së tenderit konkretisht formulari i tenderit çmimi total i tenderit i ofruar nga konzorciumi është i nënshkruar dhe vulosur nga dy anëtarët dhe vlerësimi im është se si i tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit”.

Anëtar i panelit shqyrtues pyeti EO ankues se, a keni kontestuar-atakuar OE-në të renditur i dyti dhe i treti për nga çmimi ?.

Në përgjigje përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: “JO nuk kemi atakuar këta dy OE”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: "Sa i përket marrëveshjes së konsorciumit është e vërtetë se ai nuk plotëson dhe nuk ka asnjërën deklaratë, ku nuk specifikohet asgjë. Kërkoj nga paneli që lënda të kthehet në Rivlerësim dhe të shpërblehem me kontratë pasi mendojmë se kemi të drejtë".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: "Mendoj se marrëveshjet e konsorcimit i përfshijnë kërkesat e AK. Këtu duhet pas parasysh çmimin dhe ruajtjen e buxhetit, andaj kërkojmë të mbetet në fuqi vendimi i AK dhe të hedhet e pabazuar ankesa e OE ankues".

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Pika 5 e marrëveshjes së OE-ve të rekomanduar për kontratë pas rivlerësimit, potencon se palët kontraktuese pranojnë gjitha obligimet e përbashkëta që dalin nga themelimi i këtij grapi-konzorciumi, dhe se bartin bashkërisht dhe veç e veç të gjitha detyrimet e parapara sipas dosjes së tenderit të AK-KK Ferizaj. Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e nenit 11.1 të FDT-së piken b), pasi që nuk ka ofruar një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarë duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marr pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjeter që marrin pjesë në procedurën e njëjtë të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar si duhet edhe formularin për dorëzimin e tenderit pjesën C, pasi që nuk figuron në këtë pjesë nënshkrimi i personit të autorizuar por janë të shënuar vetëm të dhënat e operatorëve ekonomik në konsorcium. Gjithashtu konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar edhe deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit siç parashihet në nenin 11.1 pika C e FDT-së por e ka ofruar një autorizim të paqartë dhe në kundërshtim me kërkesën e FDT-së dhe në kundërshtim edhe me nenin⁷¹ të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se kryesuesi i komisionit rivlerësues nuk e ka nënshkruar raportin e komisionit në fjalë, ndërsa në raportin e komisionit rivlerësues tek lista e plotë standarde për përshtatshmërinë e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale të tenderëve shënohet me fjalën "Jo" tek rubrika e regjistrimit në regjistrin profesional për konsorciumin e rekomanduar për kontratë dhe tek rubrika e tenderëve të përgjegjshëm shënohet gjithashtu me fjalën "Jo", çka do të thotë se ky konsorcium është deklaruar i papërgjegjshëm për arsyen e lartcekur. Po ashtu edhe te rubrika për grupin e operatorëve ekonomik lidhur me deklaratën e nënshkruar nga secili anëtarë për konfirmim të pjesëmarrjes është plotësuar me fjalën "Jo" për konsorciumin e rekomanduar për kontratë duke e

dekluaruar si të papërgjegjshëm këtë konsorcium. Në lidhje me raportin e rivlerësimit zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka bërë ndonjë koment por e ka nënshkruar raportin në fjalë pa ndonjë vërejtje edhe pse rekomandimi i komisionit rivlerësues është kundërthënës me vetë përpilimin dhe plotësimin e këtij rapporti nga ana e komisionit rivlerësues dhe faktikisht edhe vetë nënshkrimi i zyrtarit përgjegjës tregon kundërthënie me rekomandimin e komisionit rivlerësues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Komuna e Ferizajit”

1x1 OE – “Linda Sh.p.k” - Gerlicë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.